





# Jeni duke blerë një pajisje të re elektronike?

Ndiqni më poshtë disa nga pyetjet që duhet t'i bëni vetes.

## 1. A mund ta ndryshoj fjalëkalimin e paracaktuar?

Fjalëkalimi i paracaktuar i një pajisjeje është tepër i lehtë për t'u anashkaluar. Në thelb është një *opendoor* për pajisjen tuaj dhe të gjithë aktivitetin dhe të dhënat tuaja. Krijimi i fjalëkalimit tuaj personal është i lehtë dhe ju jep kontroll mbi informacionin që hyn dhe del.




## 2. A janë të enkriptuara të dhënat e mia personale?

Kriptimi e kthen informacionin ose të dhënat tuaja në një kod që vetëm palët e autorizuara mund të kenë akses. Përdorimi i enkriptimit mbron të dhënat tuaja personale kur ruhen në pajisje ose kur dërgohen përmes internetit.

## 3. A e përditëson automatikisht sigurinë pajisja ime?


Teknologjia përparon shpejt dhe bashkë me të shfaqen vulnerabilitete të reja sigurie. Për të mbajtur ritmin, përditësimet e sigurisë janë thelbësore. Lejimi i përditësimeve automatike në pajisjen tuaj kontribuon në ruajtjen e një niveli të lartë sigurie.



## 4. Ku ruhen të dhënat e mia dhe kush mund t'i aksesojë?

Sipas rregullores së përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave (GDPR) kompanitë duhet t'ju informojnë për:

- të dhënat që mblidhen për ju
  - kush ka akses në të
  - ku ruhen
  - për çfarë përdoren
- në mënyrë që të mund të jepni pëlqimin tuaj. Kjo siguron pajtueshmërinë me GDPR, gjithashtu garanton të drejtat tuaja të privatësisë.



## 5. Çfarë informacionesh zbulon pajisja ime për mua?

Nëse pajisja juaj ka një kamerë ose mikrofoni, mund të jetë duke i lejuar të tjerët të dëgjojnë bisedat tuaja. Pajisja juaj është përgjegjësia juaj - ndërmerrni veprime dhe zgjidhni çfarë duhet të fikni për të mbrojtur privatësinë tuaj.

